



Datë 07.12.2022
Prishtinë

Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit, në bazë të kompetencave të dhëna me nenin 4 paragrafi 2 dhe neni 3 paragrafi 3.6, lidhur me nenin 27 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, nxjerr këtë:

VENDIM

për pezullim të vendimit me nr.157/D datë 29.03.2022

1. Pezullohet Vendimi me 157/D datë 29.03.2022, lidhur me pezullimin e ndërprerjeve të shërbimeve të ujësjellësit për konsumatorët shtëpiak.
2. Obligohen të gjithë ofruesit e shërbimeve të ujit (KRU-t) që të zbatojnë pikën 1 të këtij vendimi dhe ndërprerjet eventuale të konsumatorëve nga shërbimet e ujësjellësit, nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi, duhet të bëhen në përputhje të plotë legjislacionin në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe i njëjti do jetë valid deri në një vendim tjetër, i cili do të ndërlidhet me vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me masat e reja për Covid 19.

ARSYETIM

Meqenëse Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë lehtësimin e masave epidemiologjike nga Covid-19; konsiderohet se situata në Kosovë për sa i përket rrezikut nga pandemia është reduktuar dhe se aktivitetet shoqërore dhe institucionale i janë kthyer normalitetit sikur në kohën e para pandemisë.

Duke u bazuar në:

- Kërkesat e vazhdueshme të Kompanive Rajonale të Ujësjellësit për shfuqizimin e vendimit 157/D datë 29.03.2022 i cili ka pezulluar ndërprerjet e shërbimeve të ujit për konsumatorët shtëpiak,
- Argumentimi se ky vendim ka filluar të keqpërdoret nga një numër i madh i konsumatorëve, të cilët po refuzojnë pagesën për shërbimet e pranuar dhe po paraqet pengesa të mëdha në arkëtimin e borxheve për shërbimet e ofruara (të dhënat e performancës tregojnë ulje të shkallës së arkëtimit tek të shumica KRU-të),

Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit konstaton se kërkesat e KRU-ve janë të arsyeshme dhe më këtë rast vendos që ta pezulloj Vendimin me nr.157/D të datës 29.03.2022. Pezullimi i këtij vendimi do të ndërlidhet me vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me masat e reja për Covid 19. Në rast të përkeqësimit të situatës epidemiologjike nga Covid-19, ky vendim do të shfuqizohet dhe do të ndërmerren masat e nevojshme sipas rrethanave të krijuara.

Të gjithë ofruesit e shërbimeve të ujit (KRU-t), që në rastet e ndërprerjeve eventuale të konsumatorëve nga shërbimet e ujësjellësit, duhet të kenë parasysh bazën ligjore, dhe çdo veprim që ndërmerret, duhet të bëhen në përputhje të plotë legjislacionin në fuqi.

Duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë, Drejtoresha e Autoritetit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin Shqyrtues në afat prej tetë (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij paralajmërim.

T'i dërgohet;

1x Arkivit të ARRU,

1X Të gjithë Kryeshefave Ekzekutiv të KRU-ve

1x Të gjithë Departamenteve të ARRU,

1x Njësisë për Inspektim.

